



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA E FUSHË-ARRËZ
KESHILLI

Nr. 1076 prot.

Fushë - Arrëz më 08.04 2024

VENDIM

Nr. 18. Datë, 29.03.2024

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË FUSHË - ARRËZ TË SIPËRFAQES PREJ 8335 M2 ME NR. PASURIE
2/69, ZK-1656”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1,2germa a, në Ligjin nr.8743 datë 22.02.2001 “ Për pronat e paluajtshme të shtetit”, neni 8,i ndryshuar, ligjin nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”,i ndryshuar neni 2;4;6;7;8;9;11;12,ligjin 20/2020”Për perfundimin e proceseve të kalimit të pronësisë në Rrepublikën e Shqiperisë”,ligjit 111/2018 2Për Kadastrën”. Në V.K.M nr.500,datë14.08.2001“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si edhe në Udhëzimin nr.15, datë 30.06.2003 “Mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, si edhe në Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendordhe Decentralizimit”Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njesite e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proqes nuk është i perfunduar Keshilli i Bashkise Fushe-Arrez ne mbledhjen e tij te dates 29.03.2024 , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Fushë- Arrëz , pas shqyrtimit te dokumentacionit , pas diskutimeve

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për transferimin në pronësi të Bashkisë Fushë - Arrëz të sipërfaqes së truallit prej 8335m² pasurie 2/69 në Zonën Kadastrale 1656, aktualisht në pronësi të Shtetit, që është ish- Fabrika e Fibres, truall i cili te përdoret në funksion të kthimit te hapsirave publike, në funksion të qytetareve, sipas formularit dhe planvendosjes bashkëlidhur këtij -Vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkise dhe Kadastra e Bashkisë të kryejë procedurat përkatëse ligjore deri në vendimarrjen e Këshillit të Ministrave për kalimin e pronësisë sipas pikës 1.

Ky vendim u miratua me 10 vota pro.

Vota kunder 0 vota

Vota abstenim 0 vota

Ky vendim u shpall me date date 08.04.2024

SEKRETARI

Tom CURRI

KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

